



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:084685

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855180

K.Dh.Shk.II.nr.348/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kompania Regjionale e Ujësjiellit Mitrovica” SH.A., me NUI: 810364852, me seli në Mitrovicë, rruga. Liqenit, p.n., kundër debitorit “Trepça” SH.A., me NUI: 811278747, me seli në Mitrovicë, rruga “Parku Industrial”, p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.69/23 i datës 18.10.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Trepça” SH.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.69/23 i datës 18.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.69/23 i datës 18.10.2023, ka vendosur si në vijim: I. **APROVOHET** pjesërisht prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., **ANULOHET** pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.309/22 i datës 30.12.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, për pjesën sa i përket

detyrimit kryesor në shumën prej 592.43 € (pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katërdhjetë e tre cent).

II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.309/22 të datës 30.12.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 27,710.45 €, (njëzetë e shtatëdhjetë e shtatëqind e dhjetë euro e katërdhjetë e pesë cent), së bashku me kamatë ligjore prej 8 %.

III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “Kompania Regjionale e Ujësjetës Mitrovica” SH.A., ndaj debitorit “Trepça” SH.A., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.309/22 të datës 30.12.2022 të Përmbaruesit Privat Isa Shala, për shumën e borxhit kryesor në vlerën prej 592.43 € (pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katërdhjetë e tre cent).

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori “Trepça” SH.A., për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimin KPPP.nr.69/23 i datës 18.10.2023 Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, të anulohet.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Kompania Regjionale e Ujësjetës Mitrovica” SH.A., ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimit të furnizimit me ujë, duke urdhëruar debitorin që na afat prej 7 ditësh të paguaj borxhin në shumën prej 28,302.88 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e arritshmërisë për pagesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, me bllokimin e llogarive bankare, si dhe me

regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të kreditorit deri në inkasimin e borxhit në llogari të kreditorit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke theksuar ndër të tjera se borxhi në shumën prej 28,302.88 € është parashkruar edhe atë konform dispozitave të nenit 360 par. 1 nënpar. 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Gjykatës i ka propozuar që ta anulojë urdhrin për përmbarrim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se kreditori propozimin për përmbarrim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm – ekstraktin nga librat afarist, ndërsa në lidhje me pretendimet e debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së borxhit, e njëjta nuk qëndron, për arsye se debitori i ka pranuar rregullisht shërbimet nga ana e kreditorit dhe ka bërë pagesa për ujin e shfrytëzuar, ashtu që kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit dhe atë konform nenit 368 të LMD-së dhe se në rastin konkret meqenëse palët ndërgjyqëse janë persona juridik kërkesat parashkruhen brenda tri (3) vitesh. I ka propozuar gjykatës që të bëhet ekzekutimi i urdhrin për përmbarrim në shumën e borxhit të mbetur prej 28,302.88 €.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.69/23 të datës 18.10.2023 në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Trepça” SH.A., dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarrimit P.nr.309/22 i datës 30.12.2022, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Shala, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 592.43 € (pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katërdhjetë e tre cent). Në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., ashtu që ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.309/22 të datës 30.12.2022, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Shala, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 27,710.45 €, (njëzetë e shtatëdhjetë e shtatëqind e dhjetë euro e katërdhjetë e pesë cent), së bashku me kamatë ligjore prej 8 %.Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarrimore e kreditorit “Kompania Regjionale e Ujësjetllësit Mitrovica” SH.A., ndaj debitorit “Trepça” SH.A., sipas Urdhrin Përmbarrimor P.nr.309/22 të datës 30.12.2022 të Përmbarruesit Privat Isa Shala, për shumën e borxhit kryesor në vlerën prej 592.43 € (pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katërdhjetë e tre cent).

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe atë sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 592.43 €, pasi që vlera e borxhit të kërkuar sipas urdhrin përmbartimor të lejuar nuk ka qenë në përputhje me vlerën e borxhit sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat afarist. Gjykata vlerëson se në rastin konkret në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstrakti nga librat afarist - Kartela Financiare e Konsumatorit Nr. 1115, mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri për përmbartim, periudha kohore brenda të cilës borxhi kërkohet është nga data 31.05.2021 deri me datën 29.12.2022 dhe se për këtë periudhë borxhi i përgjithshëm arrin shumën prej 27,710.45 €, ndërsa pjesa tjetër e borxhit prej 592.43 €, është shumë e borxhit për periudhën para datës 31.05.2021. Meqenëse në rastin konkret kreditori me propozimin për përmbartim të lejuar me urdhrin e përmbartuesit privat ka kërkuar shumën prej 28,302.88 €, ndërsa nga dokumenti i besueshëm Ekstrakti nga librat afarist - Kartela Financiare e Konsumatorit Nr. 1115 shuma e përgjithshme arrin në vlerën prej 27,710.45 €, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.309/22 të datës 30.12.2022, të Përmbartuesit Privat Isa Shala, pasi që ekstrakti nga librat afarist në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Shkallës së Dytë me shikim nga shkresat e lëndës ka vërejtur se Ekstrakti nga librat afarist - Kartela Financiare e Konsumatorit Nr. 1115, i plotëson kushtet edhe në kuptim të nenit 37 të LPP-së, pasi që i njëjti i është bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal. Po

ashtu edhe sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, si dhe me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e që në rastin konkret dokumenti i besueshëm-Ekstakti nga librat afariste-kartela financiare e konsumatorit nr.1115 paraqetë bazë juridike për caktimin e përmbarimit.

Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitivin II të aktvendimit të ankimuar sepse dokumenti i besueshëm-Ekstrakti nga librat afarist-Kartela Financiare e Konsumatorit Nr. 1115, mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, periudha kohore brenda të cilës borxhi kërkohet është nga data 31.05.2021 deri me datën 29.12.2022 dhe se për këtë periudhë borxhi i përgjithshëm arrin shumën prej 27,710.45 €, ndërsa pjesa tjetër e borxhit prej 592.43 €, është shumë e borxhit për periudhën para datës 31.05.2021, e cila shumë nuk përputhet me vlerën e borxhit sipas dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj

se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.348/24 me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2024:084685
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05855180